



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES , PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL

SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al

### PROJEKTVENDIM

Nr. 05 datë 10.03 2023

**“Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2023, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave”**

Në zbatim të ligjit nr 22/2018 “Për strehimin social”, kreu V neni 33,34,35,38,39 dhe të VKM nr 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”. Sipas relacionit të grupit të punës, Kryetari i Bashkisë Vau Dejës i propozon Këshillit Bashkiak Vau Dejës të :

### VENDOSI

1. Miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave (bashkëngjitur gjeni relacionin)
2. Ngarkohet për zbatimin e tij Sektori i Strehimit Social.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

**KRYETAR  
MARK BABANI**

Konceptoi:  
Specialiste Strehimit Social  
Anila Bashaj

Miratoi:  
Përgjegjëse Sektori Strehimit Social  
Ermira Mlloja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES , PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL  
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: [info@vaudejes.gov.al](mailto:info@vaudejes.gov.al)

Nr. 1741/1 Prot.

Vau-Dejes, më 09/03/2023

**Lënda:** Informacion për ngritjen e grupit të punës për nxjerrjen e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave.

**Drejtuar:** Kryetarit të Bashkisë Vau-Dejës

**Z.Mark BABANI**

Bazuar në testimet e kryera, të dhënat e marra nga përfituesit dhe aplikuesit për programin e strehimit "Bonus Qiraje", administratorët e njësisive, dhe kryepleqt e fshatrave, gjithashtu bazuar dhe në vlerat e vitit të mëparshëm për vlerën maksimale të subvencionit të qirasë.

Grupi i punës i ngritur me urdhër të brendshëm nr.99 datë 06.03.2023 i përbërë nga:

- Ermira Mlloja
- Anila Bashaj
- Edmond Gjeçaj

"Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të apartamenteve" Sipas nenit 2 pika 36, të ligjit nr. 22/2018 datë 3.5.2018, "Qira mesatare" është mesatarja e ofertave të qirave, të marra gjatë një viti, në tregun e lirë.

Qira reale, është vlera aktuale e çmimit të qirasë së një banesë të caktuar në tregun e lirë.

*Sa më lart, nevojitet përcaktimi i vlerave të qirasë mesatare të tregut të lire gjatë vitit 2023 për Njësin Administrative Vau Dejës qendër dhe njësitë administrative Bushat, Hajmel, Vig Mnelë, Temal, Shllak. Për efekt të përcaktimit të vlerave të qirasë mesatare, grupi I punës, në bashkëpunim me kryetarët e njësisive administrative, ka kryer testime të shumta në terren, në*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS

*banesat e dhëna me qira për banim. Nga studimi është konstatuar mungesa e banesave me qira ne njësitë administrative Hajmel,, Vig Mnelë Temal dhe Shllak.*

*Në bazë të dhënave që kemi mbledhur bashkinë e kemi ndarë ne tre kategori:*

- 1. Apartamente dhe shtëpia private që shtrihen përgjatë rrugëve kryesore në lagjet-qendër të qytetit.*
- 2. Apartamentet dhe shtëpia private që ndodhen në lagjet periferike dhe fshatrat përreth.*
- 3. Shtëpia private që janë të pozicionuara ne fshatrat afër zonës së hidrocentralit si Spathari dhe Ashta.*

Kemi mbledhur të dhëna për tre kategoritë duke kryer sondazhe për çdo tipologji banimi : apartament (1+1) dhe (2+1) dhe shtëpi private (2+1) dhe (3+1). Nga studimi në terren vërehet mungesa e apartamenteve (3+1). Vlerat me të cilat ofrohen objektet me qira me funksion banimi në tregun e lirë, e ndarë sipas njërive administrative luhaten si vijon:

**Njësia Administrative Vau-Dejës**

Apartament (1+1)	10 000-12 000 lekë/muaj, mesatare 11 000 lekë
Apartament (2+1)	15 000-18 000 lekë/muaj, mesatare 16 500 lekë
Shtëpi private (2+1)	20 000-22 000 lekë/muaj, mestare 21 000 lekë
Shtëpi private (3+1)	22 000-25 000 lekë/muaj, mesatare 23 500 lekë

**Njësia Administrative Bushat**

Apartament (1+1)	13 000-15 000 lekë/muaj, mesatare 14 000 lekë
Apartament (2+1)	15 000-18 000 lekë/muaj, mesatare 16 500 lekë
Shtëpi private (2+1)	20 000-22 000 lekë/muaj, mestare 21 000 lekë
Shtëpi private (3+1)	22 000-25 000 lekë/muaj, mesatare 23 500 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS

Në përfundim konfirmojmë se, vlerat maksimale të subvencionimit të qirasë, për rastet kur qiraja do të subvencionohet në masën 100% të vlerave të qirasë mesatare mujore, nga Bashkia Vau Dejës, për vitin në vijim, të jenë:

Apartament (1+1)	12 500 lekë/muaj
Apartament (2+1)	15 500 lekë/muaj
Shtëpi private (2+1)	21 000 lekë/muaj
Shtëpi private (3+1)	23 500 lekë/muaj

*Në rast se do të kemi kërkesa në njësit Hajmel, Temal, Shllak dhe Vig Mnelë, këto raste do të trajtohen sipas vlerave maksimale të subvencionimit të qirasë si më sipër.*

**Grupi i punës:**

Përgjegjëse Sektori i Strehimit Social  
Ermira Mlloja

Specialist Sektori i Strehimit Social  
Anila Bashaj

Specialist Sektori i Strehimit Social  
Edmond Gjeçaj